



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

**RREGULLORE**

**MBI**  
**ADMINISTRIMIN E FONDIT TË KOMPENSIMIT**

*Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 191, datë 26.10.2021*

**Neni 1**  
**Objekti**

Kjo rregullore përcakton rregullat e detyrueshme mbi administrimin e Fondit të Kompensimit dhe mbi delegimin, trajtimin, pagesën dhe rimbursimin e praktikave objekt i Fondit të Kompensimit, sipas parashikimeve të kësaj rregulloreje dhe legjislacionit në fuqi.

**Neni 2**  
**Përcaktimi i Termave**

Të gjithë termat e fushës mbi sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit të përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin e dhënë në ligjin nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

**Neni 3**  
**E drejta e palës së dëmtuar të paraqesë kërkesë për dëmet objekt**  
**Fond Kompensimi**

1. Pala e dëmtuar ka të drejtë të paraqesë kërkesë për dëmshpërblim pranë Byrosë për rastet e:
  - a. Dëmeve të shkaktuara nga përdorimi i mjeteve motorike të pasiguruara dhe të paignifikuara, përjashtuar rastet për të cilat i dëmtuari dëmshpërblehet drejtpërdrejt nga shoqëria e sigurimit, sipas parashikimeve të pikës 1 të nenit 43 të këtij ligji;

- b. Dëmeve shkaktuar pasagjerit në rastet kur pronari i një mjeti motorik në transportin publik nuk ka lidhur kontratë për sigurimin e pasagjerëve;
  - c. Likuidimit apo falimentimit të shoqërisë së sigurimit;
  - d. Dëmeve ndaj pronës dhe/ose personit shkaktuar ndaj mjetit motorik autobus dhe mjetit që transporton lëndë të rrezikshme.
2. Pala e dëmtuar ka të drejtë të paraqesë kërkesën për dëmshpërblim pranë Byrosë Shqiptare të Sigurimit për dëmet e shkaktuara nga mjete të pidentifikuara dhe/ose të pasiguruara të ndodhura para datës 30.06.2021.

#### **Neni 4**

#### **Llogaritja dhe Financimi i Fondit të Kompensimit**

1. Llogaritja, procedura e financimit, afati i derdhjes dhe axhustimi i Fondit të Kompensimit do të bëhet në përputhje me parashikimet e Rregulloreve të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, “Për standartet e raportimit dhe mbikëqyrjes së Byrosë Shqiptare të Sigurimit”, “Për llogaritjen e Fondit të Kompensimit, rastet e prekjës, rastet e ndërhyrjes dhe rivendosjes së vlerës minimale të këtij fondi” si dhe “Për mënyrën e administrimit dhe pagesave të dëmeve Fond Kompensimi me datë aksidenti përpara hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 32/2021”.
2. Byroja, me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve, brenda datës 31 dhjetor të çdo viti, i propozon për miratim Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, shumën e kontributit në Fondin e Kompensimit për vitin e ardhshëm kalendarik.
3. Kontributet e Fondit të Kompensimit mbahen në llogari qëllimore që do të titullohet “Fondi i Kompensimit” dhe do të shërbejë vetëm për pagesën e dëmeve objekt Fond Kompensimi.
4. Vlera minimale e Fondit të Kompensimit mbahet si fond garancie në një llogari bankare qëllimore në një nga bankat e nivelit të dytë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

#### **Neni 5**

#### **Administrimi i dëmeve objekt Fond Kompensimi**

1. Byroja është përgjegjëse për funksionimin e plotë të regjistrit elektronik të dëmeve në cilësinë e administratorit të Regjistrit sipas rregullores “Për Regjistrin elektronik të dëmeve të Byrosë Shqiptare të Sigurimit”.
2. Anëtarët raportojnë në Byro një evidencë analitike për dëmet e paguara dhe pezull Fond Kompensimi sipas nenit 41 dhe 43 të Ligjit 32/2021. Raportimi për nenin 43 të ligjit bëhet për efekt statistikor.

3. Byroja, çdo muaj bën rakordimin midis pagesave të kryera dhe detyrimit përkatës të çdo shoqërie sigurimi për Fondin e Kompensimit dhe informon anëtarët lidhur me administrimin, financimin, gjendjen dhe nevojat për fond shtesë.

## **Neni 6**

### **Mënyra, procedurat dhe afatet e trajtimit, pagesës dhe rimbursimit të dëmeve Fond i Kompensimit**

1. Byroja Shqiptare e Sigurimit për dëmet objekt fond kompensimi zbaton rregulloren e miratuar nga Autoriteti “Për përcaktimin e rregullave dhe metodologjisë së llogaritjes së dëmshpërblimit që mbulohet nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit” si dhe rregulloren “Për Regjistrin elektronik të dëmeve të Byrosë Shqiptare të Sigurimit”.
2. Për ndjekjen e procedurave, trajtimin e dëmeve, kryerjen e pagesave dhe ndjekjen e rimbursimeve nga Fondi i Kompensimit, Byroja mund të delegojë dhe autorizojë njërin prej anëtarëve të saj. Shoqëritë e sigurimit janë të detyruara të trajtojnë dhe të paguajnë dëmin nga Fond Kompensimi të deleguar nga Byroja, sipas pikës 1 të këtij neni.
3. Për rastet e dëmeve objekt i Fondit të Kompensimit të parashikuara në pikën 2 të këtij neni, Byroja bën shpërndarjen sipas sistemit të rotacionit ndërmjet të gjitha shoqërive të sigurimit anëtare të saj, duke filluar nga shoqëria e sigurimit që zotëron në vitin paraardhës përqindjen më të madhe në tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike.
4. Praktikrat e dëmeve objekt Fond Kompensimi, pas plotësimit me dokumentacionin e duhur ligjor, dërgohen nga shoqëria trajtuese për miratim pranë Byrosë duke marrë në konsideratë afatet e përcaktuara në rregulloren “Për përcaktimin e rregullave dhe metodologjisë së llogaritjes së dëmshpërblimit që mbulohet nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”. Çdo praktike dëmi duhet të ketë detyrimisht shkresën e njoftimit të shkaktarit të dëmit për vënien në dijeni për lindjen e detyrimit dhe konfirmimin e Autoritetit nëse mjeteve shkaktar rezulton ose jo i siguruar në datën e aksidentit.
5. Me miratimin e praktikës Byroja paguan dëmin ose në rast delegimi brenda 5 ditëve kalendrike dërgon pranë shoqërisë së sigurimit vendimin e miratimit dhe fotokopjen e dokumentacionit të praktikës për të vijuar pagesën, në favor të palës së dëmtuar sipas afateve ligjore.
6. Pagesa e dëmshpërblimit nga Fondi i Kompensimit bëhet vetëm për shuma, për të cilat i dëmtuari nuk ka mundësi të përfitojë nga sigurimet shoqërore ose nga ndonjë

sigurues tjetër, me të cilin mund të ketë lidhur një kontratë sigurimi për të përfituar dëmshpërblim dhe brenda kufijve të përcaktuar në Ligjin nr. 32/2021.

7. Pagesa e detyrimit kundrejt palës së tretë të dëmtuar për dëmin e shkaktuar nga mjete motorik i pasigurar sipas rasteve të parashikuara në nenin 41 dhe 43 të Ligjit 32/2021, përbën titull ekzekutiv, në kuptim të shkronjës “e”, të nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile, kundrejt personit përgjegjës që ka shkaktuar dëmin.

## **Neni 7**

### **Procedura e ndjekjes së rimbursimit**

1. Byroja Shqiptare e Sigurimit dhe/ose shoqëria e sigurimit sipas rasteve të parashikuara në nenin 3 të kësaj rregulloreje ka detyrim të:
  - a. Njoftojë shkaktarin për detyrimin e tij për pagesë;
  - b. Njoftojë shkaktarin për vlerën e përlogaritur të dëmit të cilin ai duhet të paguajë;
  - c. Njoftojë për dhënien e mundësisë shkaktarit të dëmit për ta zgjidhur çështjen direkt me palën e dëmtuar pa përfshirë Fondin e Kompensimit.
2. Kushtet dhe procedura e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni asnjëherë nuk duhet të jetë pengesë për procedurën e dëmshpërblimit kundrejt palëve të treta apo të shkelë afatet ligjore të trajtimit të kërkesës për dëmshpërblim.

## **Neni 8**

### **Rimbursimi i dëmeve të paguara nga shkaktarët e pasiguar dhe arkëtimi i tyre**

1. Rimbursimi i pagesave Fond Kompensimi për dëmet e shkaktuara nga mjete motorike të pasiguruara të parashikuara në nenin 3 të kësaj rregulloreje, bëhet nga Byroja ose nga shoqëria siguruese që ka paguar dëmin.
2. Shoqëritë e sigurimit mund të rimbursojnë në rrugë jashtëgjyqësore vlerat e dëmeve të paguara.
3. Çdo shoqëri sigurimi që rimbursion një dëm të paguar Fond Kompensimi informon Byronë e cila rakordon dhe bën regjistrimet përkatëse.
4. Arkëtimet e realizuara nga vetë Byroja nga paditë e kthimit (regresit) i shpërndahen anëtarëve në raport me përqindjen që zinte çdo anëtar në Fondin e Kompensimit në vitin në të cilin është paguar dëmi.

## **Neni 9**

### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.